

Tiranë më, 03/03/2025

ANKIM

ANKUES: Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE, me Kryetar Z. Sazan Guri, e regjistruar për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 me vendim nr. 225 datë 28 Shkurt 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, e përfaqësuar me autorizim të posaçëm bashkëngjitur nga Sazan Guri për Altin Goxhaj në dt. 1 Mars 2025 për të drejtat e ankimit, i cili është edhe personi përgjegjës për komunikimin me KQZ i Partisë Aleanca Europiane Ekologjike – AEE, me të drejta të plota autorizimi për të tretë dhe në këtë rast Studio Ligjore Meksi Law and Consluting me NUIS L91308016L që nëpërmjet avokatëve dhe pjestarëve të saj, të përfaqësojë partinë Aleanca Europiane Ekologjike – AEE)

Kontakt:

Rr. B. Biba, P.75, Sh.2, Ap. 5 (Kati i Parë), Tiranë

altingoxhaj@gmail.com

+355672004545

www.aleancakonservatore.al

OBJEKTI: Ndryshimin e vendimit nr. 230, datë 28 shkurt 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit, shpallur në seancën e datës datë 28 shkurt 2025.

DREJTUAR: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, KQZ

BAZA LIGJORE: Nenet 94, 124 e në vazhdim të Kodit Zgjedhor.

I. RRETHANAT E FAKTIT

Në datën 28 shkurt 2025 në faqen zyrtare të KQZ Shqipëri në Facebook është realizuar publikimi i njoftimit të vendimit datë 28 shkurt 2025 për miratimin e elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit me përmbajtje si mëposhtë vijon:

“Në seancën e sotme u miratuan disa elementë përmbajtësorë të fletës së votimit, të cilat pavarësisht përmbajtjes së fletës së votimit që do të miratohet rast pas rasti, do të jenë të njëjtë në çdo tip të fletës së votimit pavarësisht zonës zgjedhore përkatëse. Fleta e votimit do të përmbajë, Stemën e Republikës, Logo KQZ, elementë në formën e tekstit (Republika e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Fletë Votimi, Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 11 maj 2025, qarku, QV nr., emri i subjektit



zgjedor, emri dhe mbiemri i kryetarit të subjektit zgjedhor, shkronjat nistore të subjektit, numri rendor emër/mbiemër i kandidatëve në listën shumemërore të cilët marrin vote preferenciale, emër/mbiemër i kandidatëve në listën shumemërore) dhe elementë në formën e kuadrateve (kuadrat ku bëhet shënimi i votuesit, kuadrat ku vendoset emri i subjektit, kuadrat ku vendoset logo e subjektit, kuadrat ku vendoset numri rendor).”

Referuar vendimit nr. 230, datë 28.03.2025 në Lidhja 1 janë parashikuar elementët përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025:

1) Stema e Republikës, 2) Logo KQZ, 3) Shkrimet: a) Republika e Shqipërisë b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve c) Fletë votimi, d) Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 11 Maj 2025 e) Qarku f) QV nr. 4) Emri i subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion/ kandidat i propozuar nga zgjedhësi) 5) Emri dhe mbiemri i kryetarit të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion) 6) Shkronjat nistore të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion), 7) Logo e partisë, ose koalicionit të regjistruar si subjekt zgjedhor, 8) Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumemërore të renditur, 9) Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumemërore të cilët marrin votë preferenciale, 10) Numri rendor për parti politike ose koalicionin e partive, 11) Kuadrat (i bardhë) ku bëhet shënimi i votuesit për partinë, ose koalicionin, 12) Kuadrat (i bardhë) ku vendoset shënimi i votuesit për kandidatët e votimit preferencial.

Sic rezulton nga pjesa e këtij vendimi, por referuar dhe audios se seancës së zhvilluar përsa i përket listës së hapur, ajo është e organizuar pa numër rendor, por vetëm bazuar në renditje alfabetike të mbiemrit të kandidatëve.

Duke qenë se kjo strukturë e listës së hapur, e paidentifikuar nëpërmjet një renditjeje numerike cënon të drejtat e votuesve për të bërë një zgjedhje të qartë dhe të informuar, si dhe krijon konfuzion në procesin e votimit, duke ngritur shqetësime mbi integritetin dhe lehtësinë e ushtrimit të së drejtës së votës. Në mungesë të një renditjeje numerike të kandidatëve në listën e hapur, votuesit mund të përballen me vështirësi në gjetjen e kandidatit të preferuar, veçanërisht në raste ku listat përmbajnë një numër të madh emrash.

Gjithashtu, një organizim i tillë mund të çojë në paqartësi në numërimin dhe administrimin e votave preferenciale, duke rritur mundësinë e gabimeve ose keqinterpretimit të vullnetit të votuesve. Kjo qasje jo vetëm që bie ndesh me parimin e transparencës dhe aksesueshmërisë së procesit zgjedhor, por gjithashtu mund të favorizojë ose të dëmtojë padrejtësisht kandidatë të caktuar.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të analizohet ndikimi i këtij vendimi në të drejtat politike të qytetarëve dhe në garantimin e një procesi zgjedhor të drejtë, të qartë dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

II. ARSYETIMI LIGJOR

i. Në lidhje me legjitimitimin e palëve dhe afatin e ankimit



Neni 124 i Kodit Zgjedhor parashikon të drejtën e ankimit e cdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kundër vendimeve të KQZ-së apo KZAZ-ve.

Konkretisht në neni 124/1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se:

Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit sipas nenit 98 të këtij Kodi mund të bëhet ankim në KAS brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit. KAS shqyrton dhe vendos për ankimin e paraqitur brenda 48 orëve nga depozitimi i tij.

Partia Aleanca Europiane Ekologjike – AEE është një parti e themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, e regjistruar për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 11 maj 2025 me vendimin e datës 28 shkurt 2025 të KSHZ-së.

Duke qenë se elementët e fletës së votimit për renditjen e listës së hapur janë në kundërshtim me ligjin dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në procesin zgjedhor, ankuesi legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e vendimit objekt ankimi.

Në lidhje me legjitimimin pasiv, ky i fundit i takon KAS-it, si organ i ngarkuar me kompetencën për shqyrtimin e këtij ankimi bazuar në dispozitën e mësipërme.

Neni 98

Përmbajtja e fletëve të votimit

1. Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së.

Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.

2. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KQZ-së.

3. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në



fletën e votimit i korresponдон hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi.

4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.

5. KQZ-ja organizon hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen, menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumëvërore në KQZ apo, sipas rastit, në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

Siç rezulton nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore afati për të kundërshtuar përmbajtjen e fletës së votimit është 24 orë nga momenti i shpalljes së tij, i cili është publikuar më datë 28 shkurt 2025 në faqen e Facebook. Nga ana tjetër rezulton se në faqen e ëebit të KQZ nuk është publikuar asnjë vendimmarrje zyrtare, kështu që për përllogaritjen e afatit i referohemi momentit të shpalljes në seancë dhe për sa i përket aspekteve përmbajtësore të ankimit do i referohemi vendimit të shpallur dhe arsyetuar në seancën e datës 28 shkurt dhe pjesës arsyetuese të publikuar në faqen e KQZ në Facebook.

Për përllogaritjen e afateve, rezulton se Kodi i Procedurave Administrative, ka parashikime vetëm për afatet që llogariten në ditë, muaj dhe vite, por në çdo rast parashikimet e tij vlejnë edhe për rastet kur përllogaritjet kryhen në formë të ndryshme siç është edhe rasti konkret që përllogaritjet nga Kodi Zgjedhor kryehen në orë. Më specifikisht Kodi Zgjedhor ka parashikuar një afat prej 24 orësh për paraqitjen e ankimit. Ndërkohë neni 56 I K.Pr.A ka këtë përmbajtje:

1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.

2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.



Kështu, në qoftë se momenti i llogaritjes së afatit do të ishte data 28 shkurt 2025, afati prej 24 orësh do të përfundonte ditën e shtunë, por bazuar në parashikimet e K.Pr.A, afatet që përfundojnë në ditën e shtunë, shtyhen për në ditën e ardhshme të punës, që është data e sotshme, 3 Mars 2025. Në këtë kuptim ky ankim po paraqitet brenda afatit ligjor.

ii. Në lidhje me themelin e çështjes

Duke iu referuar vendimit nr. 28, datë 30.06.2021, të Gjykatës Kushtetuese, mund të identifikohen disa aspekte të rëndësishme në lidhje me parime thelbësore të sistemit zgjedhor dhe të drejtave të votuesve, të cilat janë relevante në analizën e vendimit të KQZ-së mbi përbërjen e fletës së votimit.

Në këtë vendim, Gjykata vlerësoi se disa dispozita të Kodit Zgjedhor, për mënyrën se si shpërndareshin mandatet, kishin sjellë kufizime të pajustificuara mbi votën parapëlqyese dhe, rrjedhimisht, mbi të drejtën e votuesve për të zgjedhur në mënyrë efektive. Ky argument mund të shtrihet edhe mbi çështjen e listës së hapur pa një numër rendor, pasi një strukturë e tillë mund të krijojë vështirësi serioze për zgjedhësit në identifikimin e kandidatëve të tyre të preferuar. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se neni 163 i Kodit Zgjedhor, në formën e mëparshme, kufizonte efektivitetin e votës parapëlqyese, duke favorizuar renditjen e kandidatëve të përcaktuar nga partitë politike. Mungesa e një renditjeje numerike në listën e hapur mund të çojë në efekt të ngjashëm, duke e bërë më të vështirë për votuesit që të identifikojnë kandidatët e tyre të preferuar dhe duke krijuar një barrierë në ushtrimin e plotë të së drejtës së tyre për të zgjedhur.

Gjykata ka theksuar rëndësinë e votës parapëlqyese si një mjet për të garantuar ndikimin real të votuesve në përzgjedhjen e përfaqësuesve të tyre. Nëse lista e hapur mbetet e organizuar vetëm në mënyrë alfabetike dhe pa një renditje numerike, atëherë votuesit përballen me një sfidë të panevojshme për të gjetur kandidatët që dëshirojnë të mbështesin. Në raste ku listat janë të gjata dhe përfshijnë një numër të madh kandidatësh, konfuzioni që mund të lindë tek votuesit rritet ndjeshëm. Ky aspekt është veçanërisht i rëndësishëm në dritën e standardeve ndërkombëtare për zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Gjykata Kushtetuese ka referuar në mënyrë të përsëritur standardet e OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias, sipas të cilave mënyra se si strukturohet fleta e votimit duhet të sigurojë një qartësi të plotë për zgjedhësit, duke shmangur çdo lloj konfuzioni apo pengese për ushtrimin e të drejtës së votës.

Në këtë kuadër, vendimi i KQZ-së për të mos përfshirë një numër rendor për kandidatët e listës së hapur sjell rreziqe të mëdha për integritetin dhe aksesueshmërinë e procesit zgjedhor. Një strukturë më e qartë dhe më transparente, ku kandidatët janë të renditur jo vetëm sipas mbiemrit, por edhe sipas një numri rendor, do të ndihmonte në garantimin e një zgjedhjeje më të informuar dhe më të lehtë për votuesit. Një organizim i tillë do të shmangte ndikime të paqëllimshme mbi shpërndarjen e votave dhe do të sigurohej që çdo kandidat të kishte një shans të barabartë në procesin zgjedhor.

Për më tepër, renditja alfabetike krijon një pabarazi të fshehur mes kandidatëve, pasi ata që ndodhen në fillim të listës kanë më shumë gjasa të marrin vëmendjen e votuesve sesa ata që



renditen më poshtë. Studime mbi sjelljen e votuesve në vende të tjera kanë treguar se renditja e emrit në fletën e votimit ndikon në rezultatet zgjedhore, pasi votuesit shpesh zgjedhin kandidatët që janë më të lehtë për t'u gjetur vizualisht. Në këtë mënyrë, një sistem pa një renditje numerike mund të krijojë avantazhe të pamërituara për një grup të caktuar kandidatësh, duke dëmtuar parimin e konkurrencës së ndershme.

Gjithashtu edhe vetë Kodi Zgjedhor në nenin 98 të tij parashikon se:

4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.

Në këtë kuptim informacioni i përcjellë nga fleta e votimit duke u bazuar në vendimin e KSHZ nuk është i qartë dhe pritët që të jetë tepër i ngarkuar, duke vështirësuar për zgjedhësit që të gjejnë në listë kandidatin e tyre të preferuar, dukë çënuar kështu parimet e nenit 98 të Kodit Zgjedhor.

Referuar videos së publikuar në linkun zyrtar <https://web.facebook.com/KQZShqiperi/videos/555647203457124> përfaqësuesi i Partisë Aleanca Europiane Ekologjike, z. Altin Goxhaj, ka ngritur shqetësimin mbi mungesën e një numri identifikues pranë emrit dhe mbiemrit të kandidatëve në fletën e votimit. Ai thekson se kjo mungesë e bën teknikisht të vështirë gjetjen e kandidatit të preferuar dhe mund të ndikojë në lënien e tij pa u shënjuar nga votuesit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi, ka vendosur që emrat e kandidatëve në listën e hapur të shfaqen pa numër identifikues. Pasojat e mungesës së numrit identifikues lidhen me:

1. Vështirësi për votuesit në identifikimin e kandidatit të preferuar:

- Numri i madh i kandidatëve për çdo parti apo koalicion e bën kërkimin më të ndërlikuar.
- Madhësia e fletës së votimit dhe renditja alfabetike e kandidatëve përbëjnë pengesë për përzgjedhjen e lehtë.
- Disa votues mund të kenë vështirësi në lexim dhe shikim, duke u ndikuar nga lodhja dhe presioni i kohës gjatë procesit të votimit.
- Shtimi i kohës së nevojshme për të gjetur kandidatin mund të shkaktojë konfuzion dhe gabime në votim.

2. Cënimi i të drejtës kushtetuese të votuesve për të votuar preferencialisht:



- Votuesit përballen me vështirësi të qëllimshme në ushtrimin e së drejtës së tyre për të zgjedhur kandidatin e preferuar.
- Procesi i komplikuar dëmton qartësinë e zgjedhjes dhe mund të dekurajojë votimin preferencial.

3. Cënimi i të drejtës kushtetuese të kandidatëve të listës së hapur

- Mungesa e një numri identifikues penalizon kandidatët, duke e bërë të vështirë dallimin e tyre në listën shumëemërore duke krijuar një avantazh të pabarabartë në garën zgjedhore.
4. Cënim i rëndë kushtetues i partive politike pjesë e koalicioneve të përfaqësuara me kandidatët e tyre në listën e hapur për t'u përfaqësuar në Kuvend dhe siguruar avantazhet kushtetuese që prodhon legjislacioni për mbështetjen e partive politike, për shkak të vështirësive të mësipërme që i krijohen votuesve për të shprehur vullnetin e tyre në favor të kandidatëve të preferuar. Partitë politike dhe koalicionet rrezikojnë të humbasin mbështetje për shkak të vështirësive të votuesve për të gjetur dhe votuar kandidatët e tyre. Procesi pa një numër identifikues ul integritetin e përfaqësimit politik dhe transparencën e zgjedhjeve.

Kërkojmë që kandidatët në listën e hapur të shoqërohen me një numër identifikues pranë emrit dhe mbiemrit të tyre në fletën e votimit. Ky ndryshim minimal është i domosdoshëm për të garantuar integritetin dhe lehtësinë e procesit zgjedhor.

Për sa më sipër, përfundimisht

KËRKOJMË

Ndryshimin e vendimit nr. 230, datë 28 shkurt 2025 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit, publikuar më datë 28 shkurt 2025 në faqen e Facebook të KQZ Shqipëri, dhe numërtimin e kandidatëve të listave shumëemërore.

PËR PALËN ANKUESE

PËRFAQËSUESI ME AUTORIZIM

Av Redon Meksi

Redon Meksi
Meksi



Altin Goxhaj

Altin Goxhaj
AG

Partia Aleanca Europiane Ekologjike – AEE

Autorizim

Tiranë 1 Mars 2025

Autorizohet **Altin Goxhaj**, që të përfaqësojë dhe të caktojë përfaqësues të autorizuar për të kryer çdo veprim procedural në apo të KQZ për të kundërshtuar apo pranuar aktet që lidhen me Zgjedhjet e 11 Majit 2025 sipas procedurave ligjore dhe administrative.

Sazan Guri

Kryetar

Sazan Guri



PARTIA ALEANCA EUROPIANE EKOLOGJIKE – AEE

AUTORIZIM (për përfaqësim ligjor të avokatëve)

Tiranë, dt 3 Mars 2025

Unë, Altin Goxhaj,
si person përgjegjës për komunikimin me KQZ i Partisë Aleanca Europiane Ekologjike – AEE, përfaqësues i Partisë Aleanca Europiane Ekologjike – AEE, (e regjistruar si Subjekt Zgjedhor në KQZ në 28.2.2025 me Nr Vendimi 225) me të drejta të plota autorizimi për të tretë, nëpërmjet autorizimit bashkëngjitur, të datës 1 Mars 2025 të dhënë prej kryetarit të Partisë, Z. Sazan Guri, autorizoj Studion Ligjore Meksi Law and Consulting me NUIS L91308016L që nëpërmjet avokatëve dhe pjestarëve të saj, të përfaqësojë partinë Aleanca Europiane Ekologjike – AEE në ankimin me objekt “Ndryshimin e vendimit datë 28 shkurt 2025 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit, publikuar më datë 28 shkurt 2025 në faqen e Facebook të KQZ Shqipëri, dhe numërtimin e kandidatëve të listave shumëemërore”, pranë cdo organi administrativ dhe gjyqësor për çështje që kanë lidhje me Zgjedhjet e 11 Majit 2025 sipas të drejtave që u njihen partive nga legjislacioni shqiptar.

Për partinë Aleanca Europiane Ekologjike – AEE

Altin Goxhaj
(me autorizim bashkëngjitur)

